REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA KORÇË

DREJTORIA E MARRËDHËNIEVE ME PUBLIKIMET
SEKTORI I MARDHËNIEVE ME PUBLIKUN

Nr. 12034 **Prot.** **Korçë, më datë** 06 / 11 **2026**

NJOFTIM

"SHPALLJE PËR VLERËSIMIN E OFERTAVE TË KONKURRENTËVE PËR MARRJEN ME QERA TË AMBIENTEVE PËR ZHVILLIMIN E AKTIVITETEVE TË ARTIZANËVE DHE PRODHUESVE KREATIVE LOKALË PËR REALIZIMIN E PROJEKTIT "*STIMULIM I INDUSTRIVE KREATIVE*"

Bazuar në Vendimin e Këshillit Bashkiak Korcë nr. 15 datë 29.01.2026 *"Për miratimin e projektit "Stimulimi i Indiustrive Kreative" dhe përzgjedhjen e partnerit për zbatimin e këtij projekti në qytetin e Korçës"*, i ndryshuar me Vendimin e Këshillit të Bashkisë nr. 63 datë 30.04.2026 *"Për ndryshimin e VKB nr. 15 datë 29.0.2026,* konfirmuar për bazueshmërinë ligjore nga Prefekti i Qarkut Korçë me shkresë nr. 543/1 prot. datë 04.05.2026, Marrëveshjes nr. 1292 prot. datë 09.02.2026 midis Bashkisë Korçë dhe Këshillit të Qarkut Korçë "Për financimin e projektit "***Stimulimi i Industrive Kreative***", dhe Urdhërit të Kryetarit të Bashkisë Korçë nr. 378, datë 08.04.2026 *"Për krijimin e komisionit të vlerësimit të ofertave të konkurrentëve për marrjen me qira të ambienteve për zhvilimin e aktiviteteve të artizanëve dhe prodhuesve kreative lokalë për realizimin e projektit "Stimulimi i industrive kreative"*, kërkesës së fondacionit Dorcas Aid International Albania" nr. 11733 prot datë 30.10.2026 me lëndë *"Kërkesë për shtimin e numrit të përfituesve të dyqaneve të artizanatit dhe hapjen e procedurave të aplikimit"*, Bashkia Korçë njofton se të gjithë subjektet që janë të interesuara për ofrimin e ofertave duhet të plotësojnë kriteret e mëposhtme:

2.1 *Përshkrimi i Ambienteve që do Marren me Qira*

- Numri i ambienteve: 2 (dy);
- Sipërfaqja e ambienteve: Jo më pak se 10 m2 për secilin ambient;
- Vendndodhja: Tek Pazari i Korçës;
- Përshkrimi: Hapësira të pamobiluara të dizajnuara për të përfshirë një mjedis zyre dhe një sallon pritjeje.Te pajisura me tualet.
- Vlera mujore e qirasë do të jetë jo më shumë se 300 lekë për m2.

2.2 *Qëllimi i Përdorimit*

Ambientet që do të merren me qira do të përdoren për zhvillimin e aktivitetit të artizanëve dhe prodhuesve kreativë lokalë për realizimin e projektit "***Stimulimi i Industrive Kreative***".

2.3 *Kriteret për Subjektet Ofertuese*

Subjektet/personat fizikë ofertues duhet të dorëzojnë dokumentacionin e mëposhtëm:

- Fotokopje të kartës së identitetit dhe/ose fotokopje të çertifikatës së regjistrimit si subjekt (Nipt-i);
- Oferta me vlerën e qirasë mujore të firmosur nga subjekti/personi fizik;
- Të paraqesin dokumentacionin e pronësisë për ambientet e ofruara. (Çertifikatë pronesie; kopje kartele dhe fragment harte treguese, të 3 (tre) muajve të fundit).
- Të ofrojnë një planimetri të ambientit të ofruar dhe/ose foto bashkangjitur;

2.4 Afatet dhe Kushtet e Qirasë

- Afati i Qirasë: Qiraja do të jetë për një periudhë 3 (*tre*) vjeçare.
- Shuma e Qirasë: Shuma e qirasë do të përcaktohet në bazë të ofertave të paraqitura dhe në përputhje me vlerën e tregut.
- Kushtet e Përdorimit: Ambientet duhet të përdoren ekskluzivisht për qëllimet e përcaktuara në projekt dhe të mirëmbahen sipas standardeve të përcaktuara nga Bashkia Korçë.

Të interesuarit duhet të dorëzojnë brenda **afatit 2 javor nga data e afishimit** dokumentacionin e kërkuar pranë **zyrës së Protokoll Arkivës në Bashkinë Korçë në zarf të mbyllur.** Vlerësimi i dokumentacionit do të bëhët në sallën e Mbledhjes, Kati i I, në dt 13 .11.2026 në Bashkinë Korçë.

Për çdo informacion të mëtejshëm, mund të kontaktoni në numrin e telefonit [+35582243353]; në adresën e postës elektronike: info@bashkiakorce.gov.al ose të vizitoni faqen zyrtare të Bashkisë Korçë.

Kjo shpallje do të afishohet në stendën e Bashkisë Korçë dhe do të publikohet në faqen zyrtare të internetit të Bashkisë Korçë.

U shpall sot në Stendat e Bashkisë Korçë dt. 06 / 11 / 2026.

Sektori i Mardhënieve me Publikun Nadiola Dalla

REPUBLIKA E SHQIPËRISË BASHKIA KORÇË

KRYETARI
Sotiraq Filo